



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT 07 AUG 2024

14-343/01-103472/24 më

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. **NDALOHET** qarkullimi i mjeteve motorike në rrugën "Fehmi Agani" nga kryqëzimi me rrugën "Migjeni" deri te kryqëzimi me rrugën "UÇK" .
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndalimi i qarkullimit i mjeteve motorike bëhet deri me datën 31.08.2024, nga ora 21:00 deri në orën 02:00.
3. Ndalimi i qarkullimit nuk përfshin mjetet motorike me rëndësi të veçantë dhe mjetet për intervenime të ndryshme nga institucionet kompetente të sigurisë si Policia e Kosovës, inspekcioni, automjetet emergjente, si dhe banorët e lagjes.
4. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike që të vendosë shenjat vertikale përkatëse për ndalimin e qarkullimit, me tabelë plotësuese nga ora 21:00 deri në orën 02:00.
5. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftoj qytetarët dhe subjektet tjera për këtë vendim, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**U DORËZOHET:**

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim;
- Drejtorisë së Inspekcioit;
- Policisë së Kosovës;
- Zyrës për marrëdhënie me publikun;
- Qendrës për shërbim me qytetar;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT  
Përparim Rama

